



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 03.04.2023

Nr: 40

Ora: 10:30

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 42, DATË 31.03.2023 TË DEPOZITUAR NGA "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 03.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: "Partia Socialiste e Shqipërisë", përfaqësuar nga Av. Mariglen Legisi;

OBJEKT: 1. Ndryshimi i vendimit nr. 31, datë 28.03.2023 i KZAZ nr. 90, Sarandë
2. Mosregjistrimi i kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore z. Gjergj Filip Merkuri

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja "c", 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, konstatoi

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Gjatë regjistrimit të kandidatëve pranë KZAZ nr. 90, Sarandë është miratuar vendimi nr. 31, datë 28.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore Gjergj Filip Merkuri”.
3. Kundër këtij vendimi, subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e e Shqipërisë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 42 regj., datë 31.03.2023. Në këtë kërkesë ankimore, subjekti kundërshton vendimin nr. 31, datë 28.03.2023 të KZAZ nr. 90, Sarandë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit, si dhe mosregjistrimin e kandidatit z. Gjergj Merkuri. Këtu vlen për t’u theksuar fakti që me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 153, datë 09.03.2023 është vendosur regjistrimi i partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
4. Përfaqësuesi i subjektit ankues, Partia Socialiste e Shqipërisë parashtroi se gjatë procesit të regjistrimit të kandidatit në KZAZ (mbledhjes së firmave mbështetëse), z. Merkuri është prezantuar si pjesëmarrës në garë, si pjesë e Partisë Socialiste të Shqipërisë, duke fshehur qëllimin e tij të vërtetë. Gjithashtu, ai u shpreh se i është drejtuar me kërkesa KZAZ nr. 90 për të verifikuar nënshkrimet e mbështetësve për kandidatin e propozuar nga zgjedhësit z. Merkuri sipas nenit 71, pika 4 të Kodit Zgjedhor. Në seancë publike të KAS-it pretendoi se nënshkrimet e listës janë të falsifikuara, duke i ndarë në zgjedhës që nuk e mbështesin kandidatin dhe në zgjedhës që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë prej kohësh.

5. KAS-i caktoi me short anëtarin z. Ledio Braho si relator dhe vendosi zhvillimin e seancës paraprake në datën 03.04.2023, ora 10:30. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, pala ankimuese, përfaqësuar nga z. Mariglen Legisi dhe subjekti zgjedhor kandidat i propozuar nga zgjedhësit z. Gjergji Filip Mërkuri, i përfaqësuar nga Av. Gentian Muça.

KAS-i konstaton:

1. Në zbatim të nenit 129 pika 3 të K.Zgjedhor, KAS:

“... bën verifikimin paraprak të kërkesës ankimore dhe vendos:

a) kalimin e kërkesës për shqyrtim;

b) mospranimin e kërkesës për shkak të mungesës së elementeve të përcaktuara në nenin 130 të këtij Kodi; ose

c) kthimin e kërkesës për plotësim të elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 126 të këtij Kodi”.

2. Në lidhje me objektin e verifikimit paraprak, KAS i referohet nenit 130 të K.Zgjedhor që parashikon se:

“KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon elementet e mëposhtme:

a) kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit;

b) legjitimitimin e ankuesit; dhe

c) respektimin e afateve ligjore për ankimin”.

Në interpretim të kësaj dispozite del qartë që të tre këto elemente duhet të plotësohen në mënyrë kumulative në mënyrë që kërkesa ankimore të konsiderohet e pranueshme për t’u shqyrtuar në themel të saj.

3. Në lidhje me kompetencën e KQZ/KAS për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore, i referohemi nenit 124 pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se **“1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër**

vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit” dhe nenit 21 pika 1 shkronja “c” e po këtij kodi që parashikon se “1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, KAS-i ushtron këto kompetenca: ... c) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat e subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ-ëve” çka e bën të qartë kompetencën e KAS për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore.

4. Në lidhje me legjitimitetin e ankuesit që kërkohet nga neni 130 shkronja “b” e K.Zgjedhor, argumentojmë se drejta e një subjekti për të paraqitur kërkesë ankimore, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e interesit të ligjshëm që ankimuesi ka ndaj vendimit objekt ankimimi. Subjektet kanë detyrimin të provojnë interesin e ligjshëm të tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe vendimit që kundërshtohet si i paligjshëm.
5. Kodi Zgjedhor në nenin 130 shkronja “b” të tij parashikon se KAS merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon (...) legjitimitimin e ankuesit. E drejta e paraqitjes së ankimit lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës ankuese e cila ngre një pretendim, dhe që kërkon të dëgjohet mbi themelin e këtij pretendimi.
6. Në momentin e regjistrimit pranë KQZ-së, çdo subjekt zgjedhor e kryen këtë veprim me vullnetin e tij dhe pa patur dijeni paraprake se cilët subjekte të tjerë do të marrin pjesë në zgjedhje dhe sa do të jetë numri i tyre. Në këtë rast çdo subjekt do të kishte interes të ligjshëm të paraqiste ankim, kundrejt vendimit të KQZ/KZAZ, për regjistrimin ose jo të vetë subjektit.
7. Në rastin konkret ankimuesi, si subjekt zgjedhor është pranuar të regjistrohet nga KQZ si i tillë dhe për rrjedhojë nuk i është cënuar asnjë interes i tij. Po ashtu edhe kandidati i propozuar prej këtij subjekti zgjedhor për kryetar të Bashkisë Sarandë është regjistruar nga KZAZ përkatëse. Regjistrimi nga KQZ/KZAZ i çdo subjekti tjetër apo mosregjistrimi i tij nuk cënon interesat e subjektit ankimues. Subjektet zgjedhore, përfshirë partitë politike, koalicionet apo kandidatët e propozuar nga një grup zgjedhësish, regjistrohen pa marrë parasysh se sa dhe cilat janë subjektet e tjera që do të regjistrohen nga KQZ/KZAZ.

8. Vullneti që subjekti zgjedhor shpreh duke u regjistruar, lidhet me interesin e tij të ligjshëm për të marrë pjesë në zgjedhje. Kërkesa për mosregjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor në këtë rast, nuk përbën interes të ligjshëm të subjektit zgjedhor. Marrja apo mosmarrja pjesë në zgjedhje e çdo partie politike, bashkimi të subjekteve në formën e koalicioneve zgjedhore apo kandidatëve të propozuar nga një grup zgjedhësish, nuk cënon interesat e ligjshme të ankimuesit si subjekt zgjedhor i regjistruar. *(Shih vendimin nr. 1, datë 09.05.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.)*
9. Duke qenë se objekt kundërshtimi është vendimi nr. 31, datë 28.03.2023 i KZAZ nr. 90 Sarandë, subjekti ankues do të duhej të provonte ekzistencën e interesit të tij që cenohet nga vendimi të cilin ai kundërshton.
10. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me vendimin nr. 12, datë 24.06.2019, ndër të tjera ka arsyetuar se *“... sa i takon legjitimitet të paditësit, vlerësoj të theksoj se për të parashtruar përpara gjykatës një kërkim të caktuar është e nevojshme që të ketë interes. Ky interes është dobja personale për të kërkuar me anë të gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të shkelur. E drejta e një subjekti për të paraqitur një padi para gjykatës, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet që ushtrojnë të drejtën për të ngritur padi para gjykatës, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme...”* (Vendimi nr. 91, date 19.03.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë)”.
11. Po ashtu, Kolegji Zgjedhor, edhe me vendimin nr. 1, datë 09.05.2019 ka arsyetuar se *“Në momentin e regjistrimit pranë K.Q.Z. çdo subjekt zgjedhor, kryen këtë veprimtari me vullnetin e tij dhe pa patur dijeni paraprake se cili subjekt do të marrë pjesë në zgjedhje dhe sa do të jetë numri i tyre në këto zgjedhje. Në këtë rast çdo subjekt do të kishte interes të ligjshëm nëse nga K.Q.Z, ky subjekt do të regjistrohej apo jo, pas kërkesës që ai do t’i bënte K.Q.Z-së. Paditësi si subjekt zgjedhor është pranuar të regjistrohet nga K.Q.Z si i tillë për rrjedhojë nuk i është cënuar asnjë interes i tij. Regjistrimi nga K.Q.Z i çdo subjekti apo mosregjistrimi i tij nuk cënon interesat e subjekteve të tjerë të cilëve u është pranuar ose jo regjistrimi si subjekt zgjedhor. Subjekti*

*zgjedhor përfshi dhe partitë politike, regjistrohen pa marrë parasysh se sa dhe cilat janë subjektet që do të regjistrohen nga K.Q.Z. **Fakti që një subjekt zgjedhor regjistrohet në zgjedhje dëshmon se interesat e tij të ligjshme lidhen vetëm me garën dhe realizimin e saj ndaj dhe kërkesa për çregjistrimin e një tjetër subjekti zgjedhor në këtë rast, nuk përbën interesa të ligjshme të subjektit zgjedhor, si kusht për ngritjen e kësaj padie në bazë të nenit 145 të Kodit Zgjedhor”.***

12. Përfundimisht, në vlerësimin e KAS, ankimuesit nuk i është shkelur ndonjë e drejtë dhe as i është cënuar interesi i ligjshëm i pretenduar. Për pasojë ai nuk legjitimohet në kundërshtimin e vendimit nr. 31, datë 28.03.2023 të KZAZ nr. 90 Sarandë. Regjistrimi i kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore z. Gjergj Filip Merkuri për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk ndryshon apo cënon kushtet e konkurrimit për asnjë nga subjektet e tjera zgjedhore.

13. Në lidhje me elementin e tretë të parashikuar nga neni 130 shkronja “c” të K.Zgjedhor, atë të respektimit të afateve ligjore për ankimin, përfaqësuesi i kandidatit të propozuar nga zgjedhësit prapësoi se ajo është jashtë afatit për shkak të tejkalimit të afatit 72 orë. Në lidhje me afatin ligjor për ankimin, i referohemi nenit 124 pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se **“1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit”**. Vendimi i KZAZ objekt ankimi është i datës 28.03.2023, ora 17:00, ndërkohë kërkesa ankimore është depozituar në KQZ në datë 31.03.2023, ora 18:30. Në lidhje me përlogaritjen e afateve, do i referohemi nenit 125 të K.Zgjedhor që parashikon se:

“1. Afatet që në Pjesët X dhe XI të këtij Kodi janë përcaktuar me orë llogariten duke përjashtuar orën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ. Në të gjitha rastet kur afatet në këtë Kod llogariten me orë, organi administrativ i ngarkuar nga ky Kod është i detyruar të shënojë në aktin administrativ orën e shpalljes së aktit. Në rast të kundërt, afati llogaritet duke filluar nga ora 8:00 e ditës pasardhëse.

2. Afatet që në këtë pjesë janë përcaktuar me ditë llogariten duke përjashtuar ditën në të cilën lind e drejta e ankimit ose detyrimi administrativ.

3. Në rast se plotësimi i afateve, sipas pikës 2 të këtij neni, bie jashtë orarit zyrtar të punës, të përcaktuar në vendimin e KQZ-së, atëherë ecja e afatit pezullohet në orën e mbarimit të orarit zyrtar dhe rifillon në orën e fillimit të orarit zyrtar në ditën pasardhëse.

4. Në rast se plotësimi i afateve bie në ditët e pushimeve ose festave zyrtare, afati fillon në ditën më të parë pasardhëse të punës.

5. Për afatet e ankimit, sipas kësaj pjese, nuk mund të ketë rivendosje në afat.

6. Për efekt të këtij neni, në rast se nga KQZ-ja nuk është përcaktuar ndryshe me vendim, orar zyrtar i punës llogaritet koha nga ora 8:00 deri në orën 16:00 dhe ditë pushimi janë dita e shtunë dhe dita e diel”.

Duke qenë se afati është i përcaktuar me ditë dhe jo me orë, KAS nuk e konsideron të bazuar prapësimin e përfaqësuesit të kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish, pasi afati i ankimit përfundonte në datën 31.03.2023, në fund të ditës për aq kohë sa gjatë periudhës zgjedhore administrata e KQZ punon me orar të tjezgjatur. Ky fakt provohet dhe nga shënimi i protokollit të KQZ në depozitimin e kësaj kërkesë ankimore.

14. Për sa argumentuam më sipër, duke qenë se nuk plotësohet elementi i legjitimitetit të ankimesit e për rrjedhojë nuk përmbushen në mënyrë kumulative të tre kushtet e parashikuara në nenin 130 të K.Zgjedhor,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 42, datë 31.03.2023, të paraqitur nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar